



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË

ФАКУЛТЕТ ЗА БИЗНИС И ЕКОНОМИЈА

FACULTY OF BUSINESS AND ECONOMY

STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

“Analiza e Performancës Financiare të komunës së Prizrenit dhe faktorët që ndikojnë atë për periudhën 2005-2019”

KANDIDATI:

Gjeni Imami

MENTORI:

Prof. Dr. Rufi Osmani

Tetovë, 2021

Përmbajtja

Lista e tabelave	5
Lista e figurave	5
Deklaratë e autorësisë.....	8
Abstrakt	9
Abstract	10
Апстракт	11
KAPITULLI I.....	12
1.1. Hyrje	12
1.2. Hipotezat	13
1.3. Metodologjia e hulumtimit	13
KAPITULLI II.....	14
2.1. Koncepti i Qeverisjes Lokale.....	14
2.2. Koncepti i financave publike	14
2.3. Koncepti i planifikimit, alokimit dhe realizimit të buxhetit komunal	15
KAPITULLI III: KORNIZA LIGJORE.....	17
3.1. Ligji për vetëqeverisje lokale	17
3.2. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë	18
3.3. Ligji për financat e pushtetit lokal	18
KAPITULLI IV: FINANCAT KOMUNALE.....	20
4.1. Të hyrat vetanake komunale.....	20
4.2. Grantet operative	21
4.2.1. Granti për shëndetësi parësore	21
4.2.2. Granti për arsim parauniversitar.....	22
4.2.3. Granti i përgjithshëm.....	22
4.3. Granti i performancës komunale në Kosovë.....	22
KAPITULLI V: DECENTRALIZIMI NË KOSOVË	24
5.1. Koncepti i decentralizimit	24
5.2. Decentralizimi fiskal.....	26

KAPITULLI VI: ANALIZA STATISTIKORE E FINANCEVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR PERIUdhËN 2005-2007 27

6.1. Të hyrat e buxhetit komunal për periudhën 2005-2007	27
6.1.1. Granti Qeveritar	29
6.1.2. Të hyrat vetanake.....	30
6.1.3. Të hyrat vetanake të bartura	31
6.1.4. Fondi i stimulimit.....	32
6.1.5. Të hyrat nga donacionet e përgjithshme	33
6.2. Shpenzimet e buxhetit komunal.....	34
6.2.1. Pagat	35
6.2.2. Mallrat dhe shërbimet.....	36
6.2.3 Shpenzimet komunale	37
6.2.4. Subvencionet	38
6.2.5. Investimet Kapitale.....	38

KAPITULLI VII: ANALIZA STATISTIKORE E FINANCEVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR PERIUdhËN 2008-2017 40

7.1. Të hyrat e buxhetit komunal për periudhën 2008-2017	40
7.1.1. Granti qeveritar	42
7.1.2. Të hyrat vetanake.....	44
7.1.3. Të hyrat vetanake të bartura	45
7.1.4. Fondi i stimulimit.....	47
7.1.5. Të hyrat nga donacionet e përgjithshme	47
7.1.6. Financimet nga huamarrjet	49
7.2. Shpenzimet e buxhetit komunal.....	50
7.2.1. Pagat	51
7.2.2. Mallrat dhe shërbimet.....	53
7.2.3. Shpenzimet komunale	55
7.2.4. Subvencionet	57
7.2.5. Investimet kapitale.....	59

KAPITULLI VIII: ANALIZA STATISTIKORE E FINANCEVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR PERIUdhËN 2018-2019 61

8.1. Të hyrat e buxhetit komunal	61
--	----

8.1.1. Granti qeveritar	62
8.1.2. Të hyrat vetanake.....	63
8.1.3. Të hyrat vetanake të bartura	64
8.1.4. Të hyrat nga donacionet e përgjithshme	65
8.1.5. Financimet nga huamarrjet	66
8.2. Shpenzimet e buxhetit komunal.....	67
8.2.1. Pagat	68
8.2.2. Mallrat dhe shërbimet.....	69
8.2.3. Shpenzimet komunale	70
8.2.4. Subvencionet	71
8.2.5. Investimet kapitale.....	71
KAPITULLI IX. REZULTATET E PERFORMANCËS FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT ..	73
9.1. Analiza e korrelacionit në mes të realizimit të shpenzimeve të buxhetit komunal dhe realizimit të investimeve kapitale	73
9.2. Analiza e realizimit të investimeve kapitale si performancë financiare në komunën e Prizrenit.....	74
KAPITULLI X: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME.....	76
10.1. Konkluzione	76
10.2. Rekomandimet	77
REFERENCAT.....	79

Lista e tabelave

Tabela 1. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	27
Tabela 2. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	34
Tabela 3. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	40
Tabela 4. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	50
Tabela 5. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	61
Tabela 6. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	67
Tabela 7. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2019	74

Lista e figurave

Grafiku 1. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	29
Grafiku 2. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	30
Grafiku 3. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	31
Grafiku 4. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	32
Grafiku 5. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	33
Grafiku 6. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	35

Grafiku 7. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	36
Grafiku 8. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	37
Grafiku 9. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	38
Grafiku 10. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007	38
Grafiku 11. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	42
Grafiku 12. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	44
Grafiku 13. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	45
Grafiku 14. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	47
Grafiku 15. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	47
Grafiku 16. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	49
Grafiku 17. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	51
Grafiku 18. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	53
Grafiku 19. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	55
Grafiku 20. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	57
Grafiku 21. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017	59
Grafiku 22. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	62

Grafiku 23. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	63
Grafiku 24. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	64
Grafiku 25. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	65
Grafiku 26. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	66
Grafiku 27. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	68
Grafiku 28. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	69
Grafiku 29. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	70
Grafiku 30. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	71
Grafiku 31. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2018-2019	71

Deklaratë e autorësisë

Unë, Gjeni Imami, deklaroj me vetëdije dhe ndërgjegje të plotë që ky punim është rezultat i punës sime të pavarur dhe jam plotësisht i vetëdijshëm që plagjiarizëm konsiderohet kopjimi i punës së bërë nga të tjerët dhe paraqitja e saj si punë e imja. Në çdo rast të vetëm në këtë punim mbështetja e tërthortë apo citimi i drejtpërdrejtë në punën e autorëve të tjerë është e deklaruar si e tillë. Unë jam plotësisht i vetëdijshëm që plagjiarizmi rezulton automatikisht me notë negative dhe do të pasojnë masa disiplinore që mund të shpijnë deri te marrja e së drejtës për të qenë student në Universitetin e Evropës Juglindore.

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi magjistrature është që të analizojë dhe të pasqyrojë performancën financiare të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës së Prizrenit nga viti 2005 deri në vitin 2019. Duke i përdorur llojet e ndryshme të metodave shkencore (statistikore, konfirmative, kualitative, analitike, kuantitative dhe krahasuese), është bërë analiza e të hyrave dhe shpenzimeve të komunës së Prizrenit për çdo vit veçmas, e paraqitur në mënyrë të detajuar në forma tabelare dhe grafikone. Çdo e hyrë dhe çdo shpenzim është kalkuluar veçmas dhe është nxjerrë indeksi i raporteve në mes të alokimit dhe të planifikimit, realizimit dhe të planifikimit po ashtu edhe të realizimit në raport me alokimin. Ky punim tregon ecurinë e rritjes së të hyrave vetanake nga viti 2005 deri në vitin 2019, ndërsa përmes raportit në mes të realizimit dhe të planifikimit të të hyrave vetanake analizohet se a ka pasur diskrepancë në mes të realizimit dhe planifikimit në këto të hyra. Gjithashtu do të tregohet rezultati i realizimit të planifikimit të grantit qeveritar për 15 vite. Të gjitha këto të gjetura janë bazuar nga të dhënat e marra nga raportet financiare zyrtare të komunës së Prizrenit dhe pasqyrat financiare. Punimi teston tri hipotezat e parashtruara, të cilat pas analizave të bëra pranohen.

Fjalët kyçe: *të hyrat vetanake, granti qeveritar, raporti, indeksi, planifikimi, alokimi, realizimi, komuna e Prizrenit, të hyrat, shpenzimet komunale.*

Abstract

The purpose of this master thesis is to analyze and reflect the financial performance of revenues and expenditures of the Municipality of Prizren from 2005 to 2019. Using different types of scientific methods (statistical, confirmatory, qualitative, analytical, quantitative and comparative), the analysis of revenues and expenditures of the Municipality of Prizren is done for each year separately, where it is presented in detail in tabular forms and graphs. Each revenue and each expense is calculated separately and the index of the ratios between allocation and planning, realization and planning as well as realization in relation to the allocation is derived. This paper shows the growth of own source revenues from 2005 to 2019, while through the relationship between the realization and planning of own source revenues it analyzes whether there was a discrepancy between the realization and planning in these revenues. The result of the realization of the government grant planning for 15 years will also be shown. All these findings are based on data obtained from the official financial reports of the Municipality of Prizren and financial statements. This paper tests the three hypotheses presented, which are all accepted after the analysis.

Keywords: *own source revenues, government grant, report, index, planning, allocation, implementation, Municipality of Prizren, revenues, municipal expenditures.*

Апстракт

Целта на овој магистерски труд е да ги анализира и одразува финансиските перформанси на приходите и расходите на Општина Призрен од 2005 до 2019 година. Користејќи различни видови научни методи (статистички, потврдни, квалитативни, аналитички, квантитативни и компаративни), анализата на приходите и расходите на Општина Призрен е направена за секоја година одделно, каде што е детално претставена во табеларни форми. И графикони. Секој приход и секој трошок се пресметуваат одделно и се изведува индексот на односите помеѓу распределбата и планирањето, реализацијата и планирањето, како и реализацијата во однос на распределбата. Овој труд го прикажува растот на приходите од сопствени извори од 2005 до 2019 година, исто така, преку односот помеѓу реализацијата и планирањето на приходите од сопствени извори, овој труд ќе покаже дали имало несовпаѓање помеѓу реализацијата и планирањето во овие приходи. Исто така, ќе биде прикажан резултатот од реализацијата на планирањето на грантот за Владата за 15 години. Сите овие наоди се засноваат на податоци добиени од официјалните финансиски извештаи на Општина Призрен и финансиските извештаи. Овој труд е направен за да ги потврди презентираниите три хипотези каде што по анализата се прифаќаат хипотезите.

Клучни зборови: *приходи од сопствени извори, државен грант, извештај, индекс, планирање, распределба, имплементација, Општина Призрен, приходи, општински расходи.*

KAPITULLI I

1.1. Hyrje

Në këtë punim do të analizohen se si planifikohen të hyrat vetanake, se si bëhet implementimi i udhëzimeve të deleguara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për destinimin e parasë publike në kategori të caktuara, si dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit dhe realizimin e të hyrave. Fokus i analizës është komuna e Prizrenit, e cila është komuna e dytë pas Prishtinës si komunë që absorbon më së shumti të hyra në vend duke krijuar kështu vetëqëndrueshmëri financiare.

Në studim do të përfshihen pesëmbëdhjetë vite, nga viti 2005 deri 2019, ku do të krahasohen tri periudha nga tri qeverisje politike të ndryshme. Në një pjesë të analizës të këtij punimi studimor do të shfrytëzohet metodologjia, ku do të përfshihet një qasje e përgjithshme e këndvështrimit në lidhje me trendet e planifikimit të të hyrave vetanake dhe realizimi i tyre. Në pjesën tjetër do të bëhet analiza e trendit në mes të planifikimit dhe realizimit të grantit qeveritar. Do të bëhet analiza e korrelacionit në mes të realizimit të shpenzimeve të buxhetit komunal dhe realizimit të investimeve kapitale. Po ashtu do të analizohen realizimet e Investimeve Kapitale për çdo periudhë. Me metodat statistikore, përmes grafikoneve dhe tabelave, do të sqarohet detajisht planifikimi dhe realizimi i buxhetit të komunës së Prizrenit.

Ky punim do të realizohet duke u bazuar në buxhet dhe raportet financiare të komunës së Prizrenit, ku përveç raporteve financiare, ky punim do të bazohet edhe në pasqyrat financiare. Analiza e pasqyrave financiare ashtu siç është e rëndësishme në sektorin privat për të kuptuar se ku qëndron financiarisht një kompani, edhe në sektorin publik e ka rëndësinë e saj. Duke analizuar treguesit financiarë, mund të kemi një pasqyrë më të qartë rreth planifikimit dhe vendimet për financim dhe realizim.¹

¹ Osmani, Analiza e Pasqyrave Financiare

1.2. Hipotezat

H1: Realizimi i projeksioneve buxhetore në periudhën e analizuar ka evidentuar përparime të pjesërishme në pjesën e të hyrave autonome (tatimore dhe jotatimore).

H2: Realizimi i granteve qeveritare tejkalon 85% e projeksioneve buxhetore dhe është i lidhur kryesisht me bashkëpunimin me Ministrinë e Financave në aspekt financiar dhe politik.

H3: Si rezultat i realizimit të pjesërishëm të të hyrave fiskale vetiake kemi trende mjaft asimetrike të realizimit të shpenzimeve operative dhe shpenzimeve kapitale.

H4: Arkëtimi më dinamik i të hyrave nga legalizimi i objekteve jolegale mund të stabilizojë performancën financiare të buxhetit të komunës së Prizrenit në perspektivë.

1.3. Metodologjia e hulumtimit

Në këtë punimin të magistraturës do të përdoren të dhënat nga raportet financiare të komunës së Prizrenit nga viti 2005 deri në vitin 2019 si dhe raportet e auditorit.

Llojet e metodave shkencore që përdoren në punim përfshijnë:

- Metoda konfirmative, ku nëpërmjet kësaj metode do të testohen hipotezat para se të bëhet matja e tyre.
- Metoda kualitative, ku do të komentohen dhe sqarohen rezultatet nga rastet studimore dhe do të bëhet krahasimi i tyre.
- Metoda e analizës, do të bazohet në raportet financiare që do të shfrytëzohen nga arkivat e komunës së Prizrenit.
- Metoda kuantitative, do të mbështetet te të dhënat numerike në mënyrë statistikore.
- Metoda krahasuese, përmes së cilës do të bëhet krahasimi i performancës financiare të komunës së Prizrenit nga viti në vit.

KAPITULLI II

2.1. Koncepti i Qeverisjes Lokale

Qeverisja lokale përfaqëson të drejtën dhe aftësinë e autoriteteve lokale, brenda kufijve ligjorë, për të rregulluar dhe menaxhuar një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike brenda përgjegjësisë së tyre dhe në interesat e popullsisë lokale.²

Kryetari dhe kuvendi i komunës janë organet kryesore të komunës. Në zgjedhje të lira dhe demokratike në sistem të drejtpërdrejtë për një mandat 4 (katër) vjeçar zgjedhen kryetari i komunës dhe anëtarët e kuvendit të komunës.³

Sipas ligjit për vetëqeverisje lokale janë përcaktuar 3 (tri) lloj kompetenca: Kompetencat vetanake, Kompetencat e deleguara dhe Kompetencat e zgjeruara. Buxheti i komunave përbëhet nga granti i qeverisë dhe të hyrave komunale. Granti qeveritar përbën shumicën absolute të buxhetit të komunave, i cili është diku 10% e totalit të buxhetit të vendit. Ndërsa, e hyra kryesore vetanake e komunave është vjelja e tatimit në pronë.⁴

2.2. Koncepti i financave publike

Financat Publike janë ndër disiplinat më të vjetra shkencore të shkencave ekonomike, të cilat merren me studimin e të hyrave dhe shpenzimeve të sektorit publik. Financat Publike mbikëqyren përmes tri niveleve: auditimi i brendshëm, auditimi i jashtëm dhe parlamenti.

Çdo organizatë buxhetore që është pranuese e parave publike është e obliguar të ketë auditor të brendshëm ose të prokurojë shërbimet e Auditorit të Brendshëm në rast se nuk e ka një të tillë.⁵ Roli i Auditorit të Brendshëm është që në raport me ligjet të shqyrtojë shpenzimet e organizatave buxhetore për të mirën e tyre.

² <https://www.rks-gov.net/AL/f50/republika-e-kosoves/qeverisja-lokale>

³ <https://www.rks-gov.net/AL/f50/republika-e-kosoves/qeverisja-lokale>

⁴ <https://www.rks-gov.net/AL/f50/republika-e-kosoves/qeverisja-lokale>

⁵ Ligji për Auditimin e Brendshëm, Nr. 02/L-74, Neni 8.1

Menaxhimi i financave publike nga institucionet publike në mënyrë të pavarur mbikëqyret nga auditorët e jashtëm. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike thotë se çdo organizatë buxhetore dhe ndërmarrje publike që është pranuese e fondeve publike duhet t'i nënshtrohet procesit të pavarur auditues.⁶ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është institucion i pavarur kushtetues për kontroll ekonomik dhe financiar të institucioneve publike dhe i cili i raporton vetëm Kuvendit të Republikës së Kosovës.⁷

Parlamenti është mbikëqyrësi i fundit dhe më i rëndësishmi i financave publike. Parlamenti si organi më i lartë legjislativ bën aprovimin final të buxhetit që Qeveria e propozon po ashtu edhe mbikëqyr se si shpenzohet buxheti.

2.3. Koncepti i planifikimit, alokimit dhe realizimit të buxhetit komunal

Në planifikimin e buxhetit të komunës marrin pjesë Kuvendi i Kosovës, Qeveria, Ministria e Financave dhe institucionet të pushtetit lokal, si kryetari dhe kuvendi i komunës. Po ashtu në këtë proces ndikim të madh kanë edhe qytetarët.

Deri më datën 1 shtator, kryetari i komunës duhet t'i dorëzojë kuvendit të komunës propozimbuxhetin për vitin e ardhshëm. Deri më 30 shtator kuvendi duhet të aprovojë dhe t'ia dorëzojë Ministrisë së Financave buxhetin e planifikuar të komunës për vitin e ardhshëm.⁸ Pasi e miraton qeveria propozimin e buxhetit të Kosovës dhe propozimin e ligjit për ndarje buxhetore, duhet të dorëzojë Kuvendit të Kosovës deri më 31 tetor. Deri më 31 dhjetor Kuvendi i Kosovës miraton buxhetin për vitin e ardhshëm.

Shuma e alokuar e mjeteve është e lidhur ngushtë me planifikimin e buxhetit. Nëse ndodh planifikimi joadekuat mund të bëhet procesi i rishikimit të buxhetit. Në alokimin e mjeteve luan rol edhe çmimi nga i cili janë fituar projektet, nëse projektin e fiton një kompani me çmim më të lirë se sa është planifikuar nga komuna e Prizrenit, mjetet do të alokohen me atë shumë sa është aplikuar dhe fituar projekti.

⁶ Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr. 03/L048, Neni 47 dhe 48

⁷ Ligji për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, Nr. 03/L-075.

⁸ <http://qeverismire.info/shq/Artikulli/planifikimi-dhe-implementimi-i-buxhetit>

Me realizim të buxhetit komunal nënkuptojmë shpenzimin e mjeteve monetare brenda vitit kalendarik të arkëtuara në llogarinë e komunës.

KAPITULLI III: KORNIZA LIGJORE

3.1. Ligji për vetëqeverisje lokale

Për qëndrueshmëri të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, ky ligj ka për qëllim që të vendosë bazën ligjore. Ky ligj përkufizon kompetencat e komunave dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, si organizimin dhe funksionimin e organeve komunale.⁹ Brenda kompetencave të tij, Kuvendi i Komunës mund të miratojë statutin e komunës, rregulloret komunale, rregulloret e punës etj. Ky ligj gjithashtu iu mundëson anëtarëve të Kuvendit të Komunës të kenë të drejtën të kërkojnë dokumente, informacione rreth punëve komunale nga kryetari i komitetit.

Ligji për vetëqeverisje lokale u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 20 shkurt 2008 dhe është ligj bazik, i cili rregullon funksionimin e pushtetit lokal në Republikën e Kosovës. LVL bazohet në parimin e subsidiaritetit, përkufizon statusin ligjor, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financimit të komunave, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndërkomunal, bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.¹⁰

Komuna është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e përbërë nga një komunitet i qytetarëve në një territor të caktuar, të përcaktuar me ligj, e cila ushtron tërë pushtetin i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për institucionet qendrore¹¹. Të gjitha organet e komunës kujdesen që qytetarët e komunës t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, kombësie apo sociale, pa dallim prone apo ndonjë statusi tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale të të gjitha niveleve.¹²

⁹ Ligji për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-040

¹⁰ Gazeta Zyrtare, 2008

¹¹ Ligji Nr.03/L-040 Për vetëqeverisje lokale, Neni 4.1

¹² Gazeta Zyrtare, 2008, Neni 4

3.2. Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,¹³ si dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji rregullon përgatitjen, realizimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të Kosovës, buxheteve komunale dhe buxheteve të entiteteve të tjera publike që financohen nga paraja publike.¹⁴ Ky ligj gjithashtu përcakton përgjegjësitë e akterëve të përfshirë në këto procese në nivel qendror e lokal.

3.3. Ligji për financat e pushtetit lokal

Ky ligj rregullon mënyrën e financimit të komunave. Nëpërmjet këtij ligji, për të zbatuar kompetencat e tyre komunale, komunat kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare. Nga të hyrat vetanake komunale dhe nga granti i përgjithshëm, në mënyrë të pavarur komunat kanë të drejtë që të menaxhojnë burimet financiare.

Ky ligj parasheh, në rast të kompetencave të deleguara nga niveli qendror (regjistrimi civil, shënimet kadastrale, etj.), ose kompetencave vetanake (ofrimi i përkujdesit dytësor shëndetësor), Qeveria ka për detyrë që të sigurojë fondet për ushtrimin e kompetencave të lartpërmendura.

Autorët amerikanë Bowman dhe Kearney paraqesin dy modele themelore të pushtetit lokal: *pushtet lokal i themeluar për qëllime të përgjithshme* dhe *pushtet lokal i themeluar për një qëllim të vetëm* (Bowman & Kearney, 2009, f. 256). Sipas këtyre autorëve dallimi në mes këtyre dy modeleve, ashtu si edhe mund të kuptohet nga emërtimet, konsiston në faktin se e para ka të bëjë me atë lloj të pushtetit lokal që është i themeluar me qëllim të ushtrimit të shumë funksioneve qeverisëse, sikurse mbledhja e taksave, ndërtimi i infrastrukturës, mirëmbajtja e parqeve etj. Ndërsa në grupin e dytë autorët në fjalë fusin atë lloj të pushtetit

¹³ Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në Republikën e Kosovës Nr.03/L-048

¹⁴ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-194

lokal që është i themeluar për të ushtruar vetëm një funksion të vetëm sikurse mund të jetë përcaktimi se si do të shpenzohet buxheti i asaj njësie të vetëqeverisjes lokale.¹⁵

Sipas LFPL-së, komunat kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës dhe burimet financiare komunale do të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale.¹⁶

Krahas kësaj, për të mirë të popullsisë së komunës, kuvendi komunal dhe zyrtarët ekzekutivë kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare, të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale ose të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm.¹⁷

¹⁵ Bowman, A., & Kearney, R. (2009). *State and local government*. Boston: Houghton Mifflin Harcourt Publishing Company.

¹⁶ Gazeta Zyrtare, 2008, Neni 2

¹⁷ Gazeta Zurtare, 2008, Neni 2

KAPITULLI IV: FINANCAT KOMUNALE

4.1. Të hyrat vetanake komunale

Në Kosovë, komunitat përveç grantit qeveritar financohen edhe nga të hyrat vetanake, ku ato mbledhen duke ofruar shërbime komunale.

Këto janë bazat ligjore për rregullimin e të hyrave vetanake

- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale
- Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi
- Ligji nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme
- Ligji nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal
- Rregulloret Vjetore Komunale për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba
- Rregulloret Vjetore Komunale për Tatimin në Pronë

Kategoritë e të hyrave vetanake janë:

- a) taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna, si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuara në bazë të këtij ligji;
- b) qiratë në pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në komunë dhe të cilat janë nën administrimin ose në pronësi të komunës;
- c) të hyrat nga shitja e pasurive komunale;
- d) të hyrat nga ndërmarrjet të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të komunës;
- e) bashkëpagesat nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të cilat ofrohen nga komuna;
- f) të hyrat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e komunës si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;
- g) interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;
- h) grantet dhe/ose donacionet nga qeveritë e huaja (përveç ndihmës financiare nga Republika e Serbisë) ose nga organizatat e jashtme, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare, si dhe institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale;

- i) të gjitha kategoritë e tjera të të hyrave të cilat janë përcaktuar si të hyra vetanake komunale në bazë të një ligji të Republikës së Kosovës.¹⁸

Këto të hyra janë të hyra direkte që do të thotë se mblidhen nga vetë administrata komunale, përveç të hyrave nga gjobat e trafikut që është e hyrë indirekte ku në fillim mblidhen nga ministritë në nivel qendror dhe më pas barten në llogarinë e komunës.

Vlera e disa prej taksave, tarifave e gjobave duhen të jenë në përputhje me ligjin. Në tatimin në pronë, bazohet në vlerën e tregut, tarifa tatimore komuna që mund të zbatohet mund të jetë në shkallën prej 0.05% deri 1% të kësaj vlere.¹⁹

Për dallim nga grantet qeveritare, të hyrat vetanake i kanë disa përparësi. Njëra ndër ta është që destinacioni i këtyre të hyrave nuk caktohet, ato mund të shfrytëzohen sipas nevojave të komunës dhe përparësia tjetër është që këto të hyra nëse nuk shfrytëzohen brenda vitit fiskal, nuk barten në buxhetin qendror por fondet nga këto të hyra barten në buxhetin komunal të vitit tjetër.

4.2. Grantet operative

4.2.1. Granti për shëndetësi parësore

Granti për shëndetësi parësore bazohet në numrin e popullsisë dhe standardeve të caktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Llogaritja e grantit për shëndetësi parësore bëhet në këtë mënyrë:

Granti për shëndetësi parësore = Numri i popullatës (i normalizuar) x (2.5 Vizita për Vizitë + 3.5 euro Shërbime për kokë banori x 3.9 euro për Shërbim).²⁰

¹⁸ Ligji për financat e pushtetit lokal, NR. 03/L-049, NENI 8

¹⁹ Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme, Nr.03/L-204

²⁰ <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Komisioni-Granteve/Komisioni-i-Granteve/Dokumentet>

4.2.2. Granti për arsim parauniversitar

Granti për arsim parauniversitar bazohet në numrin e regjistruar të nxënësve dhe standardeve të caktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Për nxënësit e pakicave etnike dhe shkollat e viseve malore, financimi është më i lartë për nxënës. Llogaritja e grantit për arsim parauniversitar bëhet në këtë mënyrë:

Granti për arsim parauniversitar = Pagat e mësimdhënësve + Pagat e personelit ndihmës dhe administrativ + Mallrat dhe shërbimet + Shpenzimet kapitale.

4.2.3. Granti i përgjithshëm

Për qëllim të financimit të kompetencave komunale, Ligji për financat e pushtetit lokal e parasheh një grant të përgjithshëm të kufizuar. Qëllimi i këtij granti në mes komunave është që ta bëjë një stabilitet tek të hyrat komunale, ta sigurojë barazinë ndërmjet komunave etj.

Granti i përgjithshëm bazohet në disa kritere:

- Për çdo komunë ndahet një shumë vjetore paushall prej 140000 euro në vit, minus 1 euro për kokë banori
- Shuma e mbetur, ndahet në mes komunave në këtë mënyrë:
- 89% sipas popullatës së përgjithshme
- 3% sipas numrit të popullsisë pakicë
- 2% për komunitat ku shumica e popullsisë është me pakicat kombëtare
- 6% sipas përmasave gjeografike të komunave

4.3. Granti i performancës komunale në Kosovë

Si vendi i parë në rajon, Kosova në vitin 2009 e aprovoi ndarjen e fondeve për komunitat të bazuar në performancë, me qëllimin e stimulimit për përmirësimin e qeverisjes lokale. Shuma e ndarë si grante të performancës komunale ndërmjet viteve 2018 dhe 2021 është rreth 14 milionë euro, ku ky grant i ndahet komunave sipas pikëve të arritura në

performancën komunale të përqendruar në tri fusha: qeverisja demokratike, menaxhimi komunal dhe ofrimi i shërbimeve.²¹

Granti i performancës komunale që do të marrin komunat do të jepet përmes sistemit financiar qeveritar (thesarit) dhe do të vihet në dispozicion të komunave si një shtesë në pjesën e investimeve kapitale të grantit të përgjithshëm, lartësia e të cilit përcaktohet në bazë të formulës për alokimin e grantit me variabla, si: madhësia e popullsisë, sipërfaqja dhe përbërja etnike, që llogariten mbi shumën fikse bazë.²²

Burimet e financimit të grantit të performancës komunale janë nga Qeveria e Kosovës, Qeveria zvicerane, Qeveria suedeze dhe Qeveria norvegjeze.

Granti i performancës komunale shpërndahet sipas rregullave dhe parimeve në vijim:

Granti i performancës komunale përdoret vetëm për investime kapitale; granti nuk mund të përdoret për paga, mallra, shërbime apo subvencione.

Investimet Kapitale duhet të realizohen mbi 75%.

Komuna është e lirë të vendosë për cilat investime do të përdoret granti i performancës komunale. Rekomandohet që brenda një cikli të financimit, komunat të fokusohen në projekte konkrete, të kufizuara në numër, për të shmangur procedurat e gjata administrative.

Granti duhet të shfrytëzohet nga komuna konform legjislacionit në fuqi. Në rast se komuna nuk e shpenzon grantin konform këtyre rregullave dhe legjislacionit në fuqi, obligimet kontraktuale ndaj operatorëve ekonomikë barten nga vetë komuna.²³

Shfrytëzimi i grantit i nënshtrohet rregullave të mbikëqyrjes dhe kontrollit konform legjislacionit në fuqi.²⁴

²¹ <https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/02/Rregullat-e-GKP-se-2021-PDF-Final-09.02.2021.pdf>

²² Formula e alokimit për grantin e përgjithshëm është në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji nr. 03/L-049)

²³ https://mapl.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/04/Granti-i-Performances_ALB_2020_04.pdf

²⁴ http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2018/10/Granti-i-Performances_ALB_2020_04.pdf

KAPITULLI V: DECENTRALIZIMI NË KOSOVË

“Decentralizimi nga aspekti kualitativ do të thotë rritja e mbikëqyrjes të qeverisjes lokale dhe rritja e autonomisë të njërive vetëqeverisëse, si nga fusha e ndërtimit të mbikëqyrjes si dhe nga aspekti i një funksionimi më të mirë vetëqeverisës të strukturave komunale” – Sadri Ferati, ish-Ministër i MAPL-së (Medija Centar, 2008).²⁵

Pasi Kosova është shtet shumetnik, decentralizimi në Kosovë është dizajnuar në kuadër të karakterit shumetnik, me qëllim që të ketë karakterin mbrojtës të shoqërisë kosovare shumetnike, i cili potencohet edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, 2008, f. Neni 3).²⁶

Decentralizimi në Kosovë i ka dy shtylla kryesore, themelimin e komunave të reja dhe autonomi më të gjerë të kompetencave.

Një nga sfidat kryesore që është ballafaquar procesi i decentralizimit ka qenë sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare, ku sipas Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për ta vënë në funksion decentralizimin janë nevojitur 35 milionë euro, siç është e paraparë me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale (KLGJ, 2009, f. 25).²⁷

5.1. Koncepti i decentralizimit

"Decentralizimi nënkupton bartjen e kompetencave nga niveli i pushtetit qendror në atë të nivelit lokal" (Colin, 2004, f. 64)²⁸

Arsye e ndarjes së pushtetit lokal nga ai qendror lidhet drejtpërsëdrejti me parimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët nga niveli i pushtetit më afër qytetarëve, lehtësimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe të afërta për qytetarët.

²⁵ Sadri Ferati, ish-Ministër i MAPL-së (Medija Centar, 2008).

²⁶ (Gazeta Zyrtare, 2008, f. Neni 3)

²⁷ (KLGJ, 2009, f.25).

²⁸ (Colin, 2004, f. 64)

Decentralizimi ndahet në decentralizimin qeverisës, decentralizimin politik dhe decentralizimin ekonomik (Acar & Ozgur, 2004, f. 165).²⁹

Decentralizimi mund të shprehet në tri forma (Stavilevci, Nociione dhe parime të administratës publike, 2005, f. 261):³⁰

1. Delegimi - bartja e kompetencave nga qendra në nivel më të ulët;
2. Decentralizimi organizativ - bartja e kompetencave dhe organizimi i njësive të reja;
3. Decentralizimi politik - bartja e kompetencave, zgjerimi organizativ në nivele më të ulëta dhe krijimi i mekanizmave kontrollues politikë ndaj niveleve më të ulëta.

Koncepti i pushtetit lokal, aq sa varet nga organet e qeverisjes qendrore, traditave të qeverisjes dhe kulturës së një shoqërie, traditave politike, po aq varet nga zhvillimi ekonomik dhe teknologjik dhe nga nevoja e përmbushjes së kërkesave të komunitetit lokal. (Keles, 2000, f. 46).³¹

Disa nga arsyet e decentralizimit në shtetet:

- Reforma politike dhe ekonomike (Shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, Rusia);
- Krizat politike të shkaktuara nga konfliktet etnike (Bosnja, Etiopia, Nigeria, Filipinet);
- Krizat politike të shkaktuara nga konfliktet rajonale (Indonezia, Mali, Senegali, Uganda, Meksika);
- Rritja e pjesëmarrjes (Argjentina, Brazili, Bolivia, India, Pakistani);
- Anëtarësimi në BE (Çekia, Sllovakia, Hungaria, Polonia);
- Kriza financiare (Rusia, Indonezia, Pakistani);
- Manovrat politike (Peru, Pakistani);
- Përmirësimi i kualitetit të shërbimeve (Kili, Uganda, Bregu i Fildishtë);
- Centralizimi (Kina, BE, Turqia);
- Evitimi i kthimit në autokraci (Amerika Latine)
- Ruajtja e sistemit komunist- Kina (Shah & Thomson, 2002, f. 79).³²

²⁹ (Acar & Ozgur, 2004, f. 165)

³⁰ (Stavilevci, Nociione dhe parime të administratës publike, 2005, f. 261)

³¹ (Keles, 2000, f. 46)

³² (Shah & Thomson, 2002, f. 79)

5.2. Decentralizimi fiskal

Decentralizimi politik dhe fiskal realizoi pjesërisht qëllimet, por zhvillimi rajonal dhe zhvillimi ekonomik lokal nuk arritën të ndërtojnë një demokraci lokale funksionuese dhe zhvillim të qëndrueshëm fiskal, rajonal dhe lokal të bashkive dhe rajoneve, ndërsa procesi është në dekadën e dytë të zbatimit praktik (Osmani, 2017).

Decentralizimi fiskal për të pasur efektet pozitive duhet që vendimmarrjet nga qeveritë lokale t'i reflektojnë më mirë nevojat dhe kërkesat e tatimpaguesve, pasi përcaktimi i politikave nga qendra nuk marrin parasysh kushtet rajonale dhe lokale në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike (Oates, 1977, 1993) (Thiessen, 2003).

Vsquez dhe McNab sugjerojnë se decentralizimi fiskal promovon rritjen ekonomike përmes përmirësimit të produktivitetit. Ata argumentuan se bartja e përgjegjësi nga niveli qendror në atë lokal do t'i stimulojë jo vetëm që të marrin në konsideratë nevojat e banorëve, por edhe të kërkojnë inovacionet e fundit në lidhje me prodhimin dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, duke ndikuar kështu edhe në koston e çmimeve që të jenë më të ulëta (Vazquez & McNab, 2003).

KAPITULLI VI: ANALIZA STATISTIKORE E FINANCAVE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR PERIUdhËN 2005-2007

6.1. Të hyrat e buxhetit komunal për periudhën 2005-2007

Tabela 1. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Të hyrat	Buxheti i planifikuar 2005-2007	Mjetet e alokuara 2005-2007	Buxheti i realizuar (shpenzuar) 2005-2007	Ind. alo/plan	Ind. real/plan	Ind. real/alo	tot. aver. Ind
Granti qeveritar 2005-2007	9,111,746	8,982,493	8,982,493	99	99	100	99
Të hyrat vetanake 2005-2007	11,623,220	11,834,280	11,834,281	102	102	100	101
Të hyrat vetanake të bartura nga 2004, 2005, 2006	3,854,359	3,854,359	3,854,359	100	100	100	100
Fondi i stimulimit	1,445,145	1,676,295	1,398,364	116	97	83	99
Te hyrat nga donacionet e përgjithshme	7,825	25,433	21,215	325	271	83	227
Totali	26,042,295	26,372,860	22,454,991	101	86	85	91

Të hyrat e komunës së Prizrenit për periudhën 2005-2007 planifikimin e buxhetit e kanë pasur 26,042,295€, ku janë alokuar 26,372,860€ ndërsa janë realizuar 22,454,991€. Indeksi i alokimit në raport me planifikim ka qenë 101%. Indeksi i realizimit në raport me planifikimin e buxhetit ka qenë 86%, ndërsa indeksi i realizimit në raport me alokimin e buxhetit ka qenë 85%. Mesatarja e tri indekseve të lartpërmendura është 91%.

Në periudhën 2005-2007, planifikimi i buxhetit për grantin qeveritar të të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 9,111,746€, ndërsa janë alokuar dhe realizuar 8,982,493€ ose 99% të alokuara nga shuma e planifikuar.

Në periudhën 2005-2007, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 11,623,220€, ndërsa janë alokuar dhe realizuar 11,834,280€ ose 102% të realizuara nga shuma e planifikuar.


Në periudhën 2005-2007, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 3,854,359€ ku alokimi dhe realizimi i saj ka qenë me index 100%, por ky burim nuk ka një karakter real si burim i të hyrave buxhetore, sepse këto mjete veç kanë qenë të angazhuara për punët e pakryera të projekteve kapitale.

Në periudhën 2005-2007, planifikimi i buxhetit për fondin e stimulimit të të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 1,445,145€, ndërsa janë alokuar 1,676,295€ ose 116% të alokuara nga shuma e planifikuar. Realizimi ka qenë 1,398,364€, ku janë shpenzuar 97% nga buxheti i planifikuar dhe 83% nga mjetet e alokuara. Indeksi mesatar për këtë periudhë ka qenë 99%.

Në periudhën 2005-2007, planifikimi i buxhetit për të hyrat nga donacionet e përgjithshme të të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 7,825€, ndërsa janë alokuar 25,433€ ose 325% të alokuara nga shuma e planifikuar. Realizimi ka qenë 21,215€, ku janë shpenzuar 271% nga buxheti i planifikuar dhe 83% nga mjetet e alokuara. Indeksi mesatar për këtë periudhë ka qenë 227%.

Të hyrat vetanake të bartura të viteve 2004, 2005 dhe 2006 arrin shumën prej 3,854,359€. Ky burim, nuk ka një rol si burim i të hyrave buxhetore, sepse këto mjete kanë qenë të angazhuara për punët e pakryera të projekteve kapitale të viteve paraprake.

6.1.1. Granti Qeveritar




Grafiku 1. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në periudhën 2005, planifikimi i buxhetit për Grantet Qeveritare të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 2,651,651€, ndërsa janë alokuar dhe realizuar mjetet në tërësi.

Në vitin 2006, planifikimi i buxhetit për Grantet Qeveritare të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 3,475,484€, ndërsa janë alokuar dhe realizuar 3,417,767€ ose 98% të alokuara dhe të realizuara nga shuma e planifikuar. Në shumën e alokuar të Grantit Qeveritar për vitin 2006 janë përfshirë edhe pagat e arsimtarëve në shumën prej 32,610€ si mbështetje.

Në vitin 2007, planifikimi i buxhetit për Grantet Qeveritare të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 2,984,611€, ndërsa janë alokuar dhe realizuar 2,920,761€ ose 98% të alokuara nga shuma e planifikuar.

6.1.2. Të hyrat vetanake



Grafiku 2. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në vitin 2005 ka pasur dallim në mes të planifikimit dhe realizimit. Planifikimi ka qenë 4,441,644€ dhe janë realizuar 3,473,028€, 79% nga shuma e planifikuar ose një ngecje prej 21% me një rënie absolute prej 938,616€.

Ndikim negativ në realizimin e të hyrave vetanake kanë pasur: taksat nga legalizimi i objekteve 16% ku planifikimi ka qenë 100,000€, ndërsa është realizuar 15,557€, qiratë nga tregjet komunale 45%, të hyrat nga participimi 44%


Në vitin 2005, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të hyrat e buxhetit komunal ka qenë 4,411,644€, ndërsa janë alokuar dhe realizuar 3,473,028€ ose 79% të alokuara dhe realizuara nga shuma e planifikuar. Indeksi mesatar për këtë periudhë ka qenë 86%.

Raportimi i realizimit dhe të alokimit të të hyrave vetanake për vitin 2006 arrin shumën prej 4,435,768€ ose 118% nga shuma e planifikuar që është 3.749,000€.

Ka vazhduar edhe këtë vit ndikimi negativ në realizimin e të hyrave vetanake nga taksat nga legalizimi i objekteve. Edhe pse në përqindje realizimi ka qenë 32%, në vlerë ka qenë 8,090€ të realizuara.

Edhe viti 2007 ka qenë vit me përqindje të lartë të realizimit dhe alokimit të të hyrave vetanake të planifikuara rreth 113%, ku janë grumbulluar shuma prej 3,925,484€ në raport me shumën e planifikuar 3,462,576€.

6.1.3. Të hyrat vetanake të bartura




Grafiku 3. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Burimi nga të hyrat vetanake të bartura nga viti paraprak nuk ka ndonjë rol si e hyrë buxhetore, sepse këto mjete kanë qenë të angazhuara për projekte kapitale të pakryera të vitit paraprak dhe gjithmonë realizohet 100% të vlerës së planifikuar. Në vitin 2005 mjetet e bartura nga viti paraprak kanë qenë 2,053,957€.

Në vitin 2006 mjetet e bartura nga viti paraprak kanë qenë me performancë të mirë në krahasim me vitin paraprak, ku janë bartur vetëm 391,270€ dhe janë përdorur 99% të shumës për investime kapitale.

Në vitin 2007 mjetet e bartura nga viti 2006 ka qenë 1,409,144€, një shumë e madhe nëse e krahasojmë me performancën e vitit paraprak.

6.1.4. Fondi i stimulimit




Grafiku 4. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në vitin 2005 fondi i stimulimit për komunën e Prizrenit nga Ministria janë derdhur në llogarinë e komunës 129,482€ si stimulim për performancën e treguar për të hyra që janë realizuar nga tatimi në pronë në vitin 2004 dhe 101,668€ të kthyer për kanalizimin në fshatin Gjonaj që ka qenë e bllokuar gabimisht nga ana e Ministrisë prej zotimeve të bartura nga grandit qeveritar për vitin 2004. Janë realizuar 191,855€, ku janë shpenzuar 83% nga shuma e mjeteve të alokuara.

Në vitin 2006 në llogarinë e komunës nga fondi i stimulimit për tatimin në pronë nga performanca e vitit 2005 ka qenë 613,525€ aq edhe sa janë alokuar. Realizimi ka qenë 509,224€ ose 83% të shpenzuara nga buxheti i planifikuar dhe i alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 89%.

Në periudhën e parë të analizës, viti 2007 ka arritur që të përfitojë shumën më të lartë nga fondi i stimulimit, prej 831,620€ nga performanca e të hyrave nga tatimi në pronë të vitit 2006. Realizimi ka qenë 690,245€ ose 83% të shpenzuara nga planifikimi i buxhetit. Indeksi mesatar për këtë kategori ka qenë 89%.

6.1.5. Të hyrat nga donacionet e përgjithshme



Grafiku 5. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në vitin 2005 komuna e Prizrenit nuk ka bërë planifikimin e donacioneve. Gjatë vitit alokon 11,763€ nga donatorët për ndërtimin e shtëpive të djegura, ndërsa i realizon 9,654€ ose 82% nga shuma e alokuar. Në vitin 2006 planifikimi për të hyrat nga donacionet ka qenë 7,825€, ndërsa është alokuar shuma prej 12,825€ ose 164% mjete të alokuara nga planifikimi i buxhetit ku 5,000€ janë shpenzuar në kanalizimin e një lagjeje. Janë realizuar 10,716€ ose 137% nga shuma e planifikuar dhe 84% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar për këtë kategori ka qenë 128%. Në vitin 2007 nuk është bërë planifikimi i të hyrave nga donacioni, por gjatë vitit kalendarik komuna e Prizrenit fiton një donacion në shumën 845€ dhe i realizon në tërësi.

6.2. Shpenzimet e buxhetit komunal

Tabela 2. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Shpenzimet	Buxheti i Planifikuar 2005-2007	Buxheti i Alokuar 2005-2007	Buxheti i Realizuar 2005-2007	Ind. alo./plan.	Ind. Real./plan.	Ind. Real./alo	Total index
Pagat	2,890,373	2,890,373	2,719,619	100	94	94	96
Mallrat dhe shërbimet	2,167,894	2,202,685	2,202,685	102	102	100	101
Shpenzimet komunale	1,816,393	1,816,393	1,712,028	100	94	94	96
Subvencionet	452,158	453,645	453,645	100	100	100	100
Investimet kapitale	15,931,072	15,931,072	15,367,014	100	96	96	98
Totali	23,257,890	23,294,168	22,454,991	100	97	96	98

Shpenzimet e buxhetit komunal për periudhën 2005-2007, planifikimin buxhetor e ka pasur 23,257,890€, ndërsa mjetet janë alokuar në tërësi. Buxheti i realizuar ka qenë 22,454,991€, ku janë shpenzuar dhe alokuar 96% nga buxheti i planifikuar. Totali i indeksit mesatar ka qenë 98%.

Nga tabela e shpenzimeve të buxhetit komunal, realizimi i pagave ka qenë 2,719,619€ në raport me planifikimin që ka qenë 2,890,373€ ose 94% të realizuara, ndërsa janë alokuar mjetet në tërësi. Indeksi mesatar për këtë kategori ka qenë 96%. Pagesa e pagave ka qenë për stafin e Administratës Lokale dhe pagesat për asambleistë.


Realizimi dhe alokimi i planifikimit të shpenzimeve për mallrat dhe shërbimet arrin në 102%, gjegjësisht 2,202,685€ të realizuara dhe të alokuara në raport me 2,167,894€ të planifikuara.

Në kategorinë mallrat dhe shërbimet hyjnë: derivatet për automjete dhe agregat, telefoni, faksi, posta, interneti, pastrimi i objekteve të komunës, mikpritja (reprezentacioni), mëditjet, shpenzimet e udhëtimit, materiale për zyrat, mirëmbajtja e objekteve të komunës,

riparimi i automjeteve dhe pajisjeve, shpenzimet e rrymës elektrike në objektin e komunës etj. Te shpenzimet komunale indeksi i realizimit në raport me planifikimin dhe alokimin e buxhetit është 94% ose 1,712,028€ të realizuara dhe 1,816,393€ të planifikuara dhe të alokuara. Në kategorinë e shpenzimeve komunale hyjnë: pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi i qytetit, shpenzimet e udhëtimit të nxënësve, bursa etj.

Planifikimi i subvencioneve ka qenë 452,158€, ndërsa realizimi 453,645€ ose 100% është realizuar buxheti i planifikuar dhe i alokuar. Këto subvencione janë shfrytëzuar për financimin e manifestimeve kulturore-artistike, sportive, aktiviteteve rinore, gjinore, shpenzimeve të udhëtimit të nxënësve, familjeve të dëshmorëve dhe fëmijët jetimë etj. Në këtë periudhë investimet kapitale kanë pasur një përqindje relativisht të mirë të realizimit nga planifikimi i buxhetit rreth 96% ose 15,367,014€ të realizuara dhe të alokuara nga 15,931,072€ nga Buxheti i Planifikuar. Indeksi mesatar për këtë kategori është 98%.

6.2.1. Pagat




Grafiku 6. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në grupin e parë të shpenzimeve komunale janë përfshirë bruto pagat e stafit të Administratës Lokale. Në vitin 2005 pagat janë realizuar dhe alokuar në shumë prej 988,860€ afër 100% nga shuma e planifikuar prej 986,242€. Administrata Lokale i ka pasur 355 të punësuar. Viti 2006 ka realizuar 94% nga planifikimi i buxhetit dhe alokimi,

respektivisht 928,352€ të realizuara nga shuma e planifikuar prej 992,172€. Indeksi mesatar për këtë kategori ka qenë 96%. Administrata Lokale i ka pasur 337 të punësuar, ndërsa është planifikuar që të ketë 352 punëtorë. Në vitin 2007 pagat janë realizuar 88% nga shuma e planifikuar, respektivisht 802,407€ të realizuara në raport me 911,959€ të planifikuara dhe të alokuara. Indeksi mesatar për këtë kategori ka qenë 92%.


6.2.2. Mallrat dhe shërbimet



Grafiku 7. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në kategorinë e dytë të shpenzimeve komunale janë mallra dhe shërbimet ose me emërtim tjetër shpenzimet operative. Në vitin 2005 është realizuar po ashtu edhe alokuar 595,459€ në raport me shumën e planifikuar, i cili është 539,578€ me indeksin e realizimit 110%. Indeksi mesatar për këtë kategori është 107%. Në vitin 2006 është realizuar 81% nga planifikimi i shpenzimeve operative, respektivisht 794,459€ të realizuara dhe të alokuara në raport me shumën e planifikuar 978,498€. Indeksi mesatar për këtë kategori është 87%. Në vitin 2007 shuma e realizuar ishte 812,767€ në raport me shumën e planifikuar 649,818€ me një indeks të realizimit 125%. Indeksi mesatar është 117%.


6.2.3 Shpenzimet komunale



Grafiku 8. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në shpenzimet komunale ose me emërtim tjetër shpenzimet publike, gjatë vitit 2005 fiskal është planifikuar shuma prej 642,119€ dhe është alokuar në tërësi. Ndërsa janë realizuar 420,786€ ose 66% nga buxheti i planifikuar dhe i alokuar. Indeksi mesatar për këtë kategori është 77%. Në vitin 2006 buxheti i planifikuar për këtë kategori ishte 439,082€, ku edhe janë alokuar mjetet në tërësi. Realizimi ka qenë 605,203€ ose 138% nga shuma e planifikuar dhe i alokuar. Indeksi mesatar për këtë kategori është 125%. Në vitin 2007 janë planifikuar mjete prej 735,192€, kurse gjatë vitit kalendarik janë realizuar 686,040€ ose 93% nga buxheti i planifikuar dhe i alokuar. Indeksi mesatar për këtë kategori ka qenë 96%.


6.2.4. Subvencionet



Grafiku 9. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në këtë kategori të shpenzimeve për vitin 2005 kalendarik nuk janë planifikuar e as realizuar asnjë mjet financiar. Në vitin 2006 është arritur që të realizohen 287,102€ ose 98% nga buxheti i planifikuar dhe i alokuar prej 292,079€ për këtë kategori. Në vitin 2007 shumën e planifikuar ishte 160,079€, ndërsa realizimi dhe alokimi ka qenë 104% ose 166,545€.

6.2.5. Investimet Kapitale



Grafiku 10. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2005-2007

Në grupin e pestë të shpenzimeve komunale janë investimet kapitale ose me emërtim tjetër Shpenzimet Kapitale.

Në vitin 2005 shuma e realizuar bashkë me zotimet e bartura nga viti 2004 është 5,976,993€ ose 86% prej shumës totale të planifikuar dhe alokuar në shumë prej 6,949,331€. Në vitin 2006 shuma e realizuar ka qenë 4,606,789€ ose 90% prej totalit të planifikuar dhe asaj të alokuar në shumën prej 4,522,652€. Nga Buxheti Komunal dhe 604,525€ nga Fondi i Stimulimit. Shuma totale e parashikuar për investime kapitale për vitin kalendarik 2006 është 5,127,177€. Në vitin 2007 për investime kapitale është realizuar shuma prej 4,783,231€, aq sa edhe janë alokuar mjetet ose 125% nga totali i shumës së planifikuar në shumën prej 3,837,738€.

**KAPITULLI VII: ANALIZA STATISTIKORE E FINANCAVE TË KOMUNËS SË
PRIZRENIT PËR PERIU DHËN 2008-2017**

7.1. Të hyrat e buxhetit komunal për periudhën 2008-2017

Tabela 3. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Të hyrat	Buxheti i planifikuar 2008-2017	Buxheti i Alokuar 2008-2017	Buxheti i Realizuar 2008-2017	Ind. alo/plan	Ind. real/plan	ind. real/alo	tot. aver. Ind
Grantet qeveritare të bartura	258,963.00	258,963.00	258,963.00	100	100	100	100
Të hyrat vetanake të bartura	12,228,545.00	12,130,936.00	11,143,332.00	99	91	92	94
Të hyrat nga donacionet e përgjithshme të bartura	751,751	751,751	728,308	100	97	97	98
Granti qeveritar	260,097,973	259,628,315	253,108,945	100	97	97	98
Të hyrat vetanake	60,395,040	47,811,120	37,077,629	79	61	78	73
Të hyrat nga donacionet e përgjithshme	3,430,117	3,474,627	2,016,356	101	59	58	73
Financimet nga huamarrjet	98,357	98,357	98,357	100	100	100	100
Totali	337,260,908	324,154,069	304,431,890	96	90	94	93

Të hyrat totale të komunës së Prizrenit për periudhën 2008-2017 planifikimin buxhetor e ka pasur 337,260,908€ dhe janë alokuar 324,154,069€ nga totali i buxhetit të planifikuar, ndërsa janë realizuar 304,431,890€. Indeksi i alokimit në raport me planifikimin ka qenë 96%


dhe indeksi i realizimit në raport me planifikimin 90%, ndërsa indeksi i realizimit në raport me alokimin 94%. Mesatarja e tri indekseve është 93%. Nga tabela e të hyrave të përgjithshme të buxhetit komunal për periudhën 2008-2017, grantet qeveritare të bartura kanë qenë 258,963€ dhe janë realizuar në tërësi. Të hyrat vetanake të bartura për këtë periudhë kanë qenë 12,228,545€ dhe janë realizuar 11,141,332€ me një indeks prej 91%. Të hyrat nga donacionet e përgjithshme të bartura kanë qenë 751,751€, ndërsa janë realizuar 728,308€ nga shuma e bartur, me një indeks prej 97%.

Granti qeveritar për këtë periudhë ka bërë planifikim të buxhetit në vlerë prej 260,097,973€, kurse alokimi i saj ka qenë 259,628,315€ dhe janë realizuar 253,108,945€ nga granti qeveritar. Indeksi në mes alokim/planifikimit arrin 100%, indeksi në mes realizim/planifikimit arrin 97%, ndërsa realizim/alokim 97%. Mesatarja totale e indekseve të grantit qeveritar për periudhën 2008-2017 është 98%.

Të hyrat vetanake për periudhën 2008-2017 buxheti i planifikuar ka qenë 60,385,040€, janë alokuar këto të hyra në shumën prej 47,811,120€, ndërsa realizimi i tyre ka qenë 37,077,629€. Indeksi alokim/planifikim është mbyllur me 79%, realizim/planifikim me 61% dhe realizim/alokim me 78%. Mesatarja e indekseve totale është 73%.

Të hyrat nga donacionet e përgjithshme buxhetin e planifikuar për periudhën 2008-2017 e kanë pasur 3,474,627€. Janë alokuar nga buxheti 3,474,627€, ndërsa janë realizuar 2,016,356€. Indeksi alokim/planifikim është 101%, indeksi realizim/planifikim 59%, ndërsa indeksi realizim/alokim 58%. Mesatarja e indeksit total është 73%.

7.1.1. Granti qeveritar



Grafiku 11. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Ky grafik tregon Planifikimin, Realizimin dhe Shpenzimet e grantit qeveritar nga viti 2008 deri në vitin 2017. Nga ky grafik mund të shihet haptas që grantet qeveritare kanë pasur rritje nga viti në vit. Performancën më të mirë të raporteve në mes planifikimit, realizimit dhe shpenzimit e ka pasur viti 2008 me një indeks prej 99.9%, ndërsa performanca më e dobët është bërë në vitin 2014 me një indeks prej 93%.

Në vitin 2008 planifikimi buxhetor për grantin qeveritare ka qenë 13,231,572€, alokimi i grantit qeveritare ka qenë 13,288,610€, ndërsa janë realizuar 13,228,610€.

Granti qeveritar për vitin 2009 ka pasur planifikim buxhetor prej 18,774,273€, ku janë alokuar në shumën prej 18,769,273€ me indeksin në këtë burim të buxhetit komunal 100%. Janë realizuar 18,644,646€. Mjetet e pashfrytëzuara nga granti qeveritar është shuma prej 124,627€.

Planifikimi i buxhetit të grantit qeveritar për periudhën 2010 ka qenë shuma prej 21,661,557€. Nga ky planifikim janë alokuar 21,661,557€. Shuma e realizuar në vitin 2010 ka qenë 21,119,192€. Në vitin 2010 janë alokuar 2,787,036€ më shumë se sa në vitin e kaluar.

Planifikimi i miratuar për vitin 2011 në komunën e Prizrenit ka qenë 26,111,912€ dhe janë alokuar 26,110,913€, ndërsa janë realizuar 26,014,953€. Në vitin 2011 janë alokuar nga granti qeveritar 4,449,356€ më shumë se vitin e kaluar.

Planifikimi i buxhetit për vitin 2012 për të hyrat nga granti qeveritar ka qenë 26,154,343€, ndërsa është alokuar shuma prej 26,154,324€, pra 100% e shumës së planifikuar. Nga buxheti komunal të grantit qeveritar është realizuar 25,683,770€ ose 98% e shumës së paraparë.

Shuma e planifikuar e buxhetit për grantin qeveritar për vitin 2013 ka qenë 27,614,666€, ndërsa janë alokuar 27,614,590€ ose 100% e shumës së planifikuar. Nga ky burim i buxhetit komunal janë realizuar 27,324,443€ ose 99% e shumës së paraparë.


Planifikimi i buxhetit të grantit qeveritar për vitin 2014 ka qenë 31,976,693€. Shuma e alokuar ka qenë 31,589,783€ ose 99% e shumës së planifikuar për vitin 2014. Shuma e realizuar ka qenë 28,783,661€ ose 90% e shumës së paraparë.

Planifikimi i buxhetit të grantit qeveritar për vitin 2015 ka qenë 31,589,220€ dhe është alokuar 100% të shumës së planifikuar. Nga ky burim i buxhetit komunal janë realizuar 30,671,904€ ose 97% e shumës së paraparë. Shuma prej 917,316€ nuk është shfrytëzuar dhe ka shkuar në suficid.

Planifikimi i buxhetit të grantit qeveritar për vitin 2016 ka qenë 31,037,090€. Shuma e alokuar deri në fundvit ka qenë 30,964,398€, pra 100% e shumës së planifikuar

Planifikimi i buxhetit të grantit qeveritar për vitin 2017 ka qenë 31,945,647€, ku është alokuar në shumën prej 31,945,647€, pra 100% e shumës së planifikuar. Shuma e realizuar ka qenë 30,869,927€ ose 97% e shumës së paraparë. Shuma prej 1,075,721€ ose 3% nga shuma e planifikuar shkon në suficid.

7.1.2. Të hyrat vetanake



Grafiku 12. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake për vitin 2008 ka qenë 4,118,500€, ndërsa janë alokuar 4,038,300€ nga buxheti i planifikuar dhe janë realizuar 3,352,857€.

Për vitin 2009, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 3,948,500€, janë alokuar 3,772,619€, ndërsa janë realizuar 3,553,850€.

Për vitin 2010, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 5,114,235€, janë alokuar 4,434,433€, ndërsa janë realizuar 3,033,560€.

Për vitin 2011, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 5,321,830€, janë alokuar në shumë prej 4,998,778€ ose 94% nga shuma e planifikimit. Janë realizuar 3,951,448€ ose 74% nga shuma e planifikuar.

Për vitin 2012, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 5,490,675€, janë alokuar 4,339,737€ ose 79% të planifikimit. Janë realizuar 3,317,381€ ose 60% të shumës së planifikuar.

Për vitin 2013, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 6,119,080€, janë alokuar 4,002,240€ ose 65% nga shuma e planifikuar dhe janë shpenzuar 3,364,988€ ose 55% e shumës së planifikuar.


Për vitin 2014, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 6,425,034€, janë alokuar 5,353,482€ ose 83% nga shuma e planifikimit dhe janë realizuar 3,634,429€ ose 57% e shumës së planifikuar.

Për vitin 2015, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 8,275,080€, janë alokuar në shumë prej 5,275,953€ ose 64% nga shuma e planifikuar dhe janë realizuar 4,064,368€ ose 49% e shumës së planifikuar.

Për vitin 2016, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 9,480,000€, janë alokuar në shumë prej 5,533,931€ ose 58% nga shuma e planifikuar dhe janë realizuar 4,679,231€ ose 49% e shumës së planifikuar ose 85% e shumës së alokuar.

Për vitin 2017, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake ka qenë 6,102,106€, janë alokuar 6,061,648€ ose 99% nga shuma e planifikimit dhe janë realizuar 4,125,517€ ose 68% e shumës së alokuar.

7.1.3. Të hyrat vetanake të bartura



Grafiku 13. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Për vitin 2008, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 784,065€, ku alokimi dhe mjetet e realizuara nga planifikimi i buxhetit për këtë kategori arrin 100%.

Për vitin 2009, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 1,114,516€, aq edhe sa janë alokuar nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuar 1,113,360€.

Për vitin 2010, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 792,658 dhe janë alokuar në tërësi nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuara 734,910€.

Për vitin 2011, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 1,458,621€, ku edhe janë alokuar në tërësi nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuar 1,436,952€ dhe shuma e pashpenzuar prej 21,669€ bartet në buxhetin e vitit 2012.

Për vitin 2012, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 1,069,000€, ku është alokuar në tërësi nga buxheti i planifikuar dhe janë realizuar 976,455€.

Për vitin 2013, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 1,114,900€ dhe janë alokuar në shumën prej 1,017,291€, ndërsa janë realizuar 887,220€ ose 80% e shumës së planifikuar.


Për vitin 2014, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 883,066€ dhe janë alokuar në tërësi nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuar 753,697€.

Për vitin 2015, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 1,848,423€ dhe janë alokuar në tërësi nga buxheti i planifikuar, ndërsa janë realizuar 1,537,404€.

Për vitin 2016, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 1,370,905 dhe janë alokuar në tërësi, ndërsa janë realizuar 1,345,623€ dhe shuma e pashfrytëzuar prej 25,282€ bartet në buxhetin e vitit të ardhshëm.

Për vitin 2017, planifikimi i buxhetit për të hyrat vetanake të bartura ka qenë 1,792,451€, aq edhe sa ka qenë shuma e alokuar, ndërsa janë realizuar 1,573,646€ kurse mjetet e pashfrytëzuara prej 218,805€ barten në buxhetin e vitit të ardhshëm.

7.1.4. Fondi i stimulimit




Grafiku 14. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Fondi i stimulimit për periudhën 2008-2017 është ndarë vetëm në vitin 2009, ku planifikimi i buxhetit për këtë kategori ka qenë 105,248€ dhe janë alokuar në tërësi, ndërsa janë realizuar 99,587€.

Në vitin 2011 është bërë planifikimi i buxhetit për këtë kategori në vlerë prej 56,907€, por nuk është alokuar asnjë shumë nga vlera e planifikuar.

7.1.5. Të hyrat nga donacionet e përgjithshme



Grafiku 15. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Në vitin 2008 planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 392,063€, ndërsa alokimi dhe realizimi i këtyre të hyrave ka qenë 100% nga planifikimi i saj.

Në vitin 2009, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 471,248€ dhe alokimi i tyre ka qenë 100% nga shuma e planifikuar, ndërsa realizimi ka qenë në vlerën prej 376,497€. Shuma e arkëtuar nga të hyrat e donacioneve të brendshme ka qenë 371,879€, ndërsa janë shpenzuar 306,174€. Të hyrat nga donatorët e jashtëm janë alokuar në shumën prej 99,369€, për ZLK 61,169€, në Drejtorinë e Arsimit 35,200€ dhe në Drejtorinë e Shëndetësisë 3000€ dhe janë realizuar 70,323€.

Në vitin 2010, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 757,714€ dhe janë alokuar 100% nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuar 57,680€. Nga të hyrat e brendshme është arkëtuar shuma prej 329,861, kurse janë realizuar 231,527€. Nga të hyrat e donacioneve të jashtëm janë alokuar 427,853€, ndërsa janë realizuar 28,534€.

Në vitin 2011, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 203,764€, aq edhe është bërë alokimi i shumës së planifikuar, ndërsa janë shpenzuar 140,117€. Nga të hyrat e donacioneve të brendshme është alokuar shuma prej 126,554€, kurse janë shpenzuar 69,066€. Nga të hyrat e donatorëve të jashtëm janë alokuar shuma prej 77,210€, ndërsa janë shpenzuar 71,051€.

Në vitin 2012, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 370,779€ dhe janë alokuar në tërësi, ndërsa janë realizuar 216,625€.

Në vitin 2013, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 308,859€ dhe janë alokuar 298,054€, ndërsa janë realizuar 203,766€.

Në vitin 2014, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 191,926€ dhe janë alokuar 164,226€ nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuar 93,642€. Nga të hyrat e donacioneve të brendshëm janë alokuar 93,120€, ndërsa janë realizuar 37,796€. Nga të hyrat e donatorëve të jashtëm janë alokuar 71,106€ dhe janë realizuar 55,846€.


Në vitin 2015, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 235,113€ dhe janë alokuar 207,414€, ndërsa janë shpenzuar 44,816€. Nga donacionet e brendshëm janë

alokuar 93,424€ dhe janë shpenzuar 28,956€. Nga donatorët e jashtëm janë alokuar 113,990€, ndërsa janë shpenzuar 15,860€.

Në vitin 2016, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 360,090€ dhe janë alokuar 100% nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuar 190,822€. Nga të hyrat e donatorëve të brendshëm janë alokuar 93,424€, ndërsa janë realizuar 28,956€. Nga të hyrat e donatorëve të jashtëm janë alokuar 149,669€, ndërsa janë realizuar 106,783€.

Në vitin 2017, planifikimi i të hyrave nga donacionet e përgjithshme ka qenë 249,275€ dhe janë alokuar 100% nga shuma e planifikuar, ndërsa janë realizuar 97,847€. Nga të hyrat prej donatorëve të brendshëm janë alokuar 199,829€, ndërsa janë realizuar 83,697€. Nga të hyrat prej donatorëve të jashtëm janë alokuar 49,446€ dhe janë realizuar 14,150€.

7.1.6. Financimet nga huamarrjet



Grafiku 16. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Hyrave të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Financimet nga huamarrjet në këtë periudhë janë bërë vetëm në vitin e fundit të kësaj periudhe, gjegjësisht në vitin 2017. Planifikimi i buxhetit për këtë kategori ka qenë 98,357€, dhe janë alokuar mjetet në tërësi nga buxheti i planifikuar, si dhe janë realizuar në tërësi. Këto të hyra janë derdhur në tërësi në Drejtorinë e Shëndetësisë.

7.2. Shpenzimet e buxhetit komunal

Tabela 4. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Shpenzimet	Planifikimi i Buxhetit 2008-2017	Alokimi i Buxhetit	Realizimi i Buxhetit	Ind. Alo/Plan	Ind. Real./plan.	Ind. Real./Alo.	Tot aver. Ind
Pagat	148,956,848	148,711,274	148,033,850	100	99	100	100
Mallrat dhe shërbimet	28,052,478	26,377,043	24,061,209	94	86	91	90
Shpenzimet komunale	8,498,834	7,963,224	7,310,223	94	86	92	91
Subvencionet	4,434,197	4,244,418	3,886,291	96	88	92	92
Investimet kapitale	147,581,079	136,953,481	121,337,819	93	82	89	88
Totali	337,523,436	324,249,440	304,629,392	96	90	94	93

Në kategorinë e shpenzimeve komunale për periudhën 2008-2017, planifikimi i buxhetit ishte 337,523,436€ ku janë alokuar 324,249,440€, ndërsa janë realizuar 304,629,392€.

Në kategorinë e pagave të shpenzimet e buxhetit komunal, është planifikuar shuma prej 148,956,848€ dhe janë alokuar 148,711,274€, ndërsa janë realizuar 148,033,850€. Indeksi i alokimit në raport me planifikimin e arrin maksimumin me 100%. Indeks maksimal e mbërrijnë edhe raporti i realizimit me planifikimin dhe realizimi me alokimin.

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, janë planifikuar 28,052,478€ dhe janë alokuar 26,377,043€, ndërsa janë realizuar 24,061,209€. Indeksi i alokimit në raport me planifikimin ka qenë 94%, realizim/planifikim 86%, ndërsa realizim/ alokim 91%. Kjo kategori ka rezultuar me një indeks mesatar prej 90%.


Te kategoria e shpenzimeve komunale të shpenzimet e buxhetit komunal, janë planifikuar 8,498,834€ dhe janë alokuar 7,963,224€, ndërsa janë realizuar 7,310,223€. Indeksi i alokimit në raport me planifikimin ka qenë 94%, raporti realizim me planifikimin ka qenë 86%, ndërsa

raporti realizimit me alokimin ka qenë 92%. Kjo kategori mesataren e indeksin e ka pasur 91%.

Te kategoria e subvencioneve te shpenzimet e buxhetit komunal, janë planifikuar 4,434,197€ dhe janë alokuar në shumën prej 4,244,418€, ndërsa janë realizuar 3,886,291€. Indeksi i alokimit në raport me planifikimin ka qenë 96%, indeksi realizimi në raport me planifikim ka qenë 88%, ndërsa indeksi realizim në raport me alokimin ka qenë 92%. Mesatarja e tri indekseve në këtë kategori është 92%.

Te kategoria e investimeve kapitale te shpenzimet e buxhetit komunal, buxheti i planifikuar ka qenë 147,581,079€ dhe janë alokuar 136,953,481€, ndërsa janë realizuar ose shpenzuar 121,337,819€. Indeksi i alokimit në raport me planifikimin ka qenë 93%, indeksi i realizimit në raport me planifikimin ka qenë 82%, ndërsa indeksi realizim në raport me alokimin ka qenë 89%. Mesatarja e indekseve në këtë kategori është 88%.

7.2.1. Pagat



Grafiku 17. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Në kategorinë e pagave te shpenzimet e buxhetit komunal për vitin 2008 janë përfshirë bruto pagat e stafit të Administratës Lokale, pagesat për punët e kontraktuara, pagat e asambleistëve dhe punët jashtë orarit. Për këtë periudhë janë planifikuar 8,778,183€ dhe janë alokuar 8,751,618€, ndërsa janë realizuar 8,671,253€. Indeksi i alokimit në raport me

planifikimin ka qenë 100%, realizimet në raport me planifikimin 99%, ndërsa realizimet në raport me alokimin 99%. Indeksi mesatar ka qenë 99% në këtë kategori.

Në vitin 2009, te kategoria e pagave te shpenzimet e buxhetit komunal janë planifikuar 10,283,683€ dhe janë alokuar 10,226,633€ me një indeks prej 99%. Janë realizuar 10,111,816€, ku indeksi realizim në raport me planifikimin ka qenë 98%, kurse realizim në raport me alokimin ka qenë 99%. Indeksi mesatar ka qenë 99%.

Në vitin 2010 janë planifikuar 11,271,443€ dhe janë realizuar 11,250,649 me një indeks maksimal prej 100%. Janë shpenzuar 11,129,125€ ku indeksi shpenzim në raport me planifikimin ka qenë 99%, ndërsa indeksi shpenzimet në raport me alokimin ka qenë gjithashtu 99%. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 99%.

Në vitin 2011 janë planifikuar 14,421,864€ për kategorinë e pagave dhe janë alokuar 14,421,862€ me një indeks maksimal prej 100%. Janë realizuar 14,403,387€, ku indeksi i raportit realizim/planifikimet dhe realizim/alokimet e arrijnë gjithashtu indeksin maksimal prej 100%.

Në vitin 2012, planifikimi i buxhetit për kategorinë e pagave ka qenë 14,897,153€ dhe janë alokuar 14,894,244€ me indeksin maksimal prej 100%. Janë realizuar 14,856,793€, ku indeksi realizim/planifikim dhe realizim/alokim e mbërrin 100%.

Në vitin 2013 janë planifikuar 15,151,374€ dhe janë alokuar 15,140,568€, ndërsa janë realizuar 15,139,595€. Indeksi mesatar për këtë vit e arrin maksimumin prej 100%.


Në vitin 2014, planifikimi i buxhetit për kategorinë e pagave ka qenë 17,917,124€, ndërsa janë alokuar 17,906,048€ me indeksin maksimal të alokimit në raport me planifikimin. Janë realizuar 17,766,430€ me indeksin 99% të realizimeve në raport me planifikimin dhe njëjtë në raport me alokimin. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 99%.

Në vitin 2015, planifikimi i buxhetit për kategorinë e pagave ka qenë 18,281,955€, ndërsa janë alokuar 18,217,150€ me indeksin maksimal të alokuar në raport me planifikimin. Janë realizuar 18,258,306€. Indeksi mesatar për këtë vit e arrin maksimumin prej 100%.

Në vitin 2016, planifikimi i buxhetit për kategorinë e pagave ka qenë 19,030,280€, ndërsa janë alokuar 18,938,501€ dhe janë realizuar 18,919,547€. Indeksi mesatar për këtë vit arrin maksimumin prej 100%.

Në vitin 2017, planifikimi i buxhetit për kategorinë e pagave ka qenë 18,923,789€, ku janë alokuar 18,910,001€ me një indeks të alokimit në raport me planifikimin prej 100%. Janë realizuar 18,777,598€ dhe indeksi realizim/planifikim dhe realizim/alokim e arrijnë 99%. Indeksi mesatar për vitin e fundit të kësaj periudhe për këtë kategori është 99%.

7.2.2. Mallrat dhe shërbimet



Grafiku 18. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

Në vitin 2008, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 2,466,849€ dhe janë alokuar 2,438,767€ ose 99%. Realizimet kanë qenë 2,369,348€, ku janë shpenzuar 96% nga shuma e planifikuar dhe 97% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar ka qenë 97%.

Në vitin 2009, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 2,180,471€ dhe janë alokuar 100% nga shuma e planifikuar. Realizimet kanë qenë 2,145,014€, ku janë shpenzuar 98% nga shuma e planifikuar dhe të alokuar. Indeksi mesatar ka qenë 99%.

Në vitin 2010, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 2,498,412€ dhe janë alokuar 2,475,978€ ose 99%. Realizimet kanë qenë 2,340,380€, ku janë shpenzuar 94% nga shuma e planifikuar dhe 95% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar ka qenë 96%.

Në vitin 2011, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 2,381,735€ dhe janë alokuar 2,303,464€ ose 97%. Realizimet kanë qenë 2,133,270€, ku janë shpenzuar 90% nga shuma e planifikuar dhe 93% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 93%.

Në vitin 2012, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 2,337,815€ dhe janë alokuar 2,233,510€ ose 96% nga shuma e planifikuar. Realizimet kanë qenë 2,082,843€ ku janë shpenzuar 89% nga shuma e planifikuar dhe 93% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 93%.

Në vitin 2013, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 3,156,268€ dhe janë alokuar 2,987,580€ ose 95% nga shuma e planifikuar. Realizimet kanë qenë 2,585,716€, ku janë shpenzuar 82% nga shuma e planifikuar dhe 87% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 88%.


Në vitin 2014, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 3,388,150€ dhe janë alokuar 2,752,581€ ose 81% nga shuma e planifikuar. Realizimet kanë qenë 2,477,087€ ku janë shpenzuar 73% nga shuma e planifikuar dhe 90% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 81%.

Në vitin 2015, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 3,124,676€ dhe janë alokuar 2,720,482€ ose 87% nga shuma e planifikuar. Realizimet kanë qenë 2,448,605€, ku janë shpenzuar 78% nga shuma e planifikuar dhe 90% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 85%.

Në vitin 2016, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet të shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 3,083,195€ dhe janë alokuar 2,875,506€ ose 93% nga shuma e planifikuar. Realizimet kanë qenë 2,807,989€ ku janë shpenzuar 91% nga shuma e planifikuar dhe 98% nga shuma e alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 94%.

Në vitin 2017, planifikimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet te shpenzimet e buxhetit komunal ka qenë 3,434,907€ dhe janë alokuar 3,408,252€ ose 99% nga buxheti i planifikuar. Realizimet kanë qenë 2,670,957€ ose 78% nga shuma e planifikuar dhe alokuar. Indeksi mesatar për këtë vit ka qenë 85%.

7.2.3. Shpenzimet komunale



Grafiku 19. Përpunuar nga autori në bazë të të dhënave të Raporteve Financiare të Shpenzimeve të Buxhetit të komunës së Prizrenit 2008-2017

